

**AKT THEMELIMI**


I

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"CLO Integrated Solutions"**

**Sh.p.k**

18 Gusht 2023



**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"CLO Integrated Solutions" Sh.p.k.**

Bazuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", dhe ligjit 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", unë i nënshkruari Bledar Cenameri, në përputhje me vullnetin e tim të lirë, sot më 18.08.2023, themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "CLO Integrated Solutions" sh.p.k. sipas kushteve të mëposhtme:

**Neni 1 – Emri**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "CLO Integrated Solutions" Sh.p.k.

**Neni 2 – Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", N. 110, Ap. 14/1, Tiranë.

**Neni 3 – Objekti**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Të kryejë çdo dhe të gjitha aktivitetet e ligjshme dhe/ose të angazhohet në çdo akt apo aktivitet të ligjshëm për të cilat mund të krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar me ndryshimet përkatëse që mund të pësojë duke përfshirë por pa u kufizuar në shërbime furnizimi personeli, shërbime ndërmjetësimi në tregun e punës, agjenci punësimi të përkohshëm dhe rekrutimi, shërbime konsulence dhe ndërmjetësimi të ndryshme, në fushën e shitjeve, telemarketing dhe sektorë të tjerë të ndërmarrë çdo aktivitet dhe të kryejë çdo veprim në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar, që kanë lidhje direkte ose indirekte me objektin e sipërpërmendur të Shoqërisë ose që janë të nevojshëm për promovimin e aktivitetit dhe synimeve të Shoqërisë.

Ofrimi i shërbimeve të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, borxheve të këqija të kreditorëve të ndryshëm individëve, personave fizikë dhe juridikë, të të tretët me ose pa vendim gjykatë. Negocimit për garantimin e shlyerjes së kredive të dhëna nga kredidhënësi dhe kryerje e çdo shërbimi apo veprimi të nevojshëm për këtë qëllim; konsulencë tregtare biznesi dhe financiare, konsulencë në fushën fiskale dhe të zhvillimit të biznesit duke përfshirë këtu veprimtari që konsistojnë në asistencë direkte në fushën e zhvillimit dhe promovimit të marrëdhënieve të bizneseve me aktoret financiare, përfshirë bankat, institucionet financiare jobanke dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë, kryerjen e funksioneve të agentit financiar dhe të kredive. Shoqëria mundëson gjithashtu ofrimin e shërbimit call-center dhe konsulences financiare për realizimin e qëllimeve të mësipërme.

Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe realizimi i çdo aktiviteti tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor.

**Neni 4 – Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen nga dita e krijimit dhe regjistrimit të saj, dhe e pa kufizuar.

#### **Neni 5 – Drejtimi**

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, ose sipas rastit Ortaku i Vetëm që përbëhet nga themeluesi; dhe
2. Administratori.

Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen për një periudhë prej 5 (pesë) vjeçare. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Bledar Cenameri.

#### **Neni 6 – Kapitali**

Kapitali fillestar i Shoqërisë 100,000 (njëqind mijë) Lekë, shlyhet tërësisht nga ortaku i vetëm themelues.

#### **Neni 7 – Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë ushtrimor fillon ditën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të shoqërive dhe mbyllet më 31 Dhjetor 2023.

#### **Neni 8 – Të tjera**


Shoqëria krijohet dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi, Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë, si dhe në përputhje me statutin që do të konsiderohet pjesë përbërëse e këtij akti.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplar, në gjuhën shqipe dhe do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky akt pasi u lexua nga ortakët themelues dhe pasi është gjetur në përputhje me vullnetin e tyre të lirë firmoset rregullisht në datë 18/08/2023.

Emri dhe firma e ortakut themelues:

- Z. Bledar Cenameri

  
(emër, mbiemër, firmë)